



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 759, datë 23.9.2020

P Ë R

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.202, DATË 5.3.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT
TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020,
PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja "a", të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në pikën 2.1, të vendimit nr.202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

"2.1. Fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë 4 633 532 035 (katër miliardë e gjashtëqind e tridhjetë e tre milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, nga i cili:

- a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 2 733 483 882 (dy miliardë e shtatëqind e tridhjetë e tre milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekësh pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në

funkSION të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 4708/1
DATE 25.9. 2020

MINISTRIT TË SHETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
BASHKISË SË TIRANËS
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

